

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË SHËRBIMIT
PYJOR GJIROKASTËR**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor, Gjirokastrë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësimit mjedisor” për periudhën 01.01.12-30.04.14, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 127 datë 19.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 530/5 datë 26.02.2013, dërguar Z. Spiro Dhjamanti, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Pyjor, Gjirokastrë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

MASA ORGANIZATIVE

1. Në lidhje me procedurat e ndjekura për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla rezultoi se për të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla nuk ka kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga sektorët përkatës në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 92 datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë,”. Për vitin 2013 në 8 raste në vlerën 149,076 lekë, procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla nuk janë kryer në formë elektronike.

Për këtë rekomandojmë:

Nga DSHP të merren masa që procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla të bëhen në mënyrë elektronike në përputhje me kërkesat e VKM nr. 47 datë 23.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45 datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” të ndryshuar dhe udhëzimin nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin e APP nr.5 datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr.1 datë 28.02.2014 dhe të sigurohen gjurmët e auditit për gjithë procedurën në zbatim të Urdhrit të MF nr.33 datë 11.07.2013 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Vazhdimisht

2. Në lidhje me administrimin e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara u konstatua se, për gjithë karburantin e përdorur për një muaj nga magazina pritej fletë-dalje mujore, e cila firmosej nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim dhe nga titullarët e institucioneve përkatëse. Për ditët e shtuna dhe të diela si dhe festat ka përdorim të karburantit për raste kontrollesh, ku në autorizimet përkatëse të përdorimit të karburantit nuk është përcaktuar specifika dhe veçantia e qëllimit të lëvizjes të këtyre rasteve.

Për këtë rekomandojmë:

Nga DSHP të merren masa që për shpenzimin e karburantit të plotësohet në mënyrë të plotë dokumentacioni autorizues, vërtetues e justifikues i lëvizjes së këtij lloj aktiviteti në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik” pika 10, 35, 36, 38.

3. Në procesin e dhënjes së kullotave e livadheve me qera, për kullotjen e bagëtive dhe kositjen e barit, nga ana e Seksionit të Administrimit dhe Menaxhimit, nuk është hartuar plani i mbarështimit të kullotave, plan i cili në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar me ligjin nr. 9996, datë 22.08.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin Kullosor" duhet të hartohet para dhënjes me qera të sipërfaqes së kullotave.

Për këtë rekomandojmë:

Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, DRSHP të hartojë planin e mbarështimit të kullotave, para dhënies me qira të sipërfaqes së planifikuar për kullotë.

Menjëherë

4. Në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" dhe pikën 1, kreun II, të udhëzimit nr.4, datë 10.04.2008 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënjen e tyre për kullotje dhe koitje bari", Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Gjirokastrë nuk ka miratuar në MM listën e kullotave të gatshme për kullotje për sezonin përkatës, si dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja.

Për këtë rekomandojmë:

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" si dhe pikën 1, kreu II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari", DRSHP të marrë masa për të dërguar për miratim në Ministrinë e Mjedisit, listën e kullotave në inventar dhe ato të gatshme për sezonin përkatës, si dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja.

Menjëherë

5. DSHP nuk ka hartuar planveprimin për dhënjet me qira të fondit kullosor, veprim në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" si dhe pikën 1, kreu II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari".

Për këtë rekomandojmë:

DRSHP të hartojë planveprimin për dhëniet me qira të fondit kullosor, plan i cili duhet të përmbajë parcelat e nënparcelat konkrete, sipërfaqen, vendndodhjen, kapacitetin kullosor, infrastrukturën që e shoqëron, si pjesën përgatitore për hartimin e procesverbalit të vlerësimit të kullotës, masat mbi zbatimin e mënyrave të mbarështimit të kullotave, në mënyrë të veçantë për parandalimin e zjarreve, gërryerjes dhe të degradimit të tokës, ruajtja e mbulesës barishtore nga mbikullotja dhe mirëmbajtja e infrastrukturës veçanërisht e asaj ujëmbajtëse, masat për ruajtjen e ekosistemeve natyrore kullosore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të

burimeve kullosore, ruajtjen dhe nxitjen e aftësive prodhuese të kullotave dhe livadheve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin e lartpërmendur.

Menjëherë

6. Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit, për dhënien e kullotave me qira, ka zbatuar procedura në mënyrë jo të plotë me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, kreun II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008.

Për këtë rekomandojmë:

Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit, për dhënien e kullotave me qira, të zbatojë procedurat në mënyrë të plotë me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, kreun II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari”.

Menjëherë

7. Në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” si dhe pikën 7, kreun II, të udhëzimit nr.4, datë 10.04.2008, vendimet e marra nga drejtoria për dhënien me qera të kullotavë, janë pasqyruar në një vendim të vetëm për të gjitha kërkesat për sezonin veror dhe atë dimëror.

Për këtë rekomandojmë:

Në zbatim të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” si dhe pikën 7, kreun II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008, DRSHP pas administrimit me nr. protokollit të pasqyrojës në mënyrë të qartë vendimet që do të marrë për dhënien e fondit kullosor me qira, kriteret e përmbushura nga subjekti përfitues, sipas kërkesave të paraqitura për sezonin veror dhe atë dimëror.

Menjëherë

8. Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 10.4.2008, pika 7, kreu III “kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje”, nuk ka dokumentuar sondazhet e kryera gjatë periudhës së kullotjes, në lidhje me mos lejimin e futjes së bagëtive mbi kapacitetin kullosor të kontraktuar”.

Për këtë rekomandojmë:

Seksioni i Administrimit dhe Menaxhimit, të zbatojë Udhëzimin nr. 4, datë 10.4.2008, pika 7, kreu III “kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullosor për kullotje”, dhe të dokumentojë sondazhet e kryera gjatë periudhës së kullotjes, në lidhje me mos lejimin e futjes së bagëtive mbi kapacitetin kullosor të kontraktuar”.

Deri më 31.12.204

9. Në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar për periudhën 01.01.2012 e në vazhdim, dosjet përkatëse, nuk kishin të depozituar kërkesën nga fermeri, gjeneralitetet e tij, ekonominë

kullosore që kërkohet, numrin e parcelës, sipërfaqen e saj, llojin e bagëtisë dhe numrin e krerëve që do të kullosin si dhe kohën e përdorimit të kullotës.

Për këtë rekomandojmë:

Në zbatim të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", dosjet për periudhën objekt auditimi e në vazhdim, të pajisen me dokumentacionin përkatës si kërkesën nga fermeri, gjeneralitetet e tij, ekonominë kullosore që kërkohet, numrin e parcelës, sipërfaqen e saj, llojin e bagëtisë dhe numrin e krerëve që do të kullosin, kohën e përdorimit të kullotës, afatin e kërkuar dhe kopjen e vendimit me nr. prot., e datë për çdo kërkesë.

Deri më 31.12.2014

10. Në zbatim të VKM nr. 632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje bari", si dhe Udhëzimit të ministrit të Mjedisit nr. 318, datë 01.01.2008 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve, për procedurat e dhënies së tyre për kullotje dhe kositje bari", për kontratat me përdorim të përkohshëm deri në tre vjet, në momentin e nënshkrimit të tyre në një rast është kryer me vonesë pagesa për vitin e parë në një këst.

Për këtë rekomandojmë:

Në zbatim të VKM nr. 632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje bari", si dhe Udhëzimit të ministrit të Mjedisit nr. 318, datë 01.01.2008 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve, për procedurat e dhënies së tyre për kullotje dhe kositje bari", për kontratat me përdorim të përkohshëm deri në tre vjet, në momentin e nënshkrimit të tyre të kryhet pagesa e plotë.

Deri më 31.12.2014

11. Në pyjet shtetërorë për vitet 2012, 2013, 2014 në DSHP Gjirokastrë nuk janë planifikuar ngastra të cilat do të trajtoheshin me shfrytëzime dhe në pyjet komunale aplikohen shfrytëzime vetëm për furnizimin e fshatarësisë për nevojat e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

DSHP Gjirokastrë në fillim të çdo viti të planifikojë dhe listojë ngastrat pyjore në inventar të miratuar, të cilat do të trajtohen për shfrytëzim sipas ligjit.

Deri më 31.12.2014

12. Drejtoria e Shërbimit Pyjor Gjirokastrë nuk disponon evidencë, si dhe të dhënat që përcakton VKM nr. 22, datë 09.01.2008 "Mbi përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal", konkretisht të pikës 14, që ka të bëjë me plotësimin e nevojave të familjeve të njësisë së qeverisjes vendore gërma "a"-për prerjen dhe mbledhjen e lëndës drusore për ndërtim e dru zjarri; gërma "b"- për vjeljen e bimëve mjekësore dhe të prodhimeve të tjera dytësore, pyjore dhe gërma "c"-krasitjen e gjetheve dhe kositjen apo grumbullimin e barit për ushqim dhe kullotje të bagëtisë.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Shërbimit Pyjor Gjirokastrë të hartojë evidenca të sakta, si dhe të pasqyrojë e të plotësojë të dhënat që përcakton VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Mbi përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, konkretisht të pikës 14, që ka të bëjë me plotësimin e nevojave të familjeve të njësisë së qeverisjes vendore gërma “a”-për prerjen dhe mbledhjen e lëndës drusore për ndërtim e dru zjarri; gërma “b”- për vjeljen e bimëve mjekësore dhe të prodhimeve të tjera dytësore, pyjore dhe gërma “c”-krasitjen e gjetheve dhe kositjen apo grumbullimin e barit për ushqim dhe kullotje të bagëtisë.

Menjëherë

13. Nuk ka të dhëna se si kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10 të VKM nr. 22, datë 09.01.2008, që kanë të bëjnë me mënyrën e planifikimit të miratimit dhe të shfrytëzimit të resurseve pyjore.

Për këtë rekomandojmë:

Të krijohet baza e të dhënave elektronikisht dhe fizikisht në lidhje me zbatimin e kërkesave të përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10 të VKM nr. 22, datë 09.01.2008, që kanë të bëjnë me mënyrën e planifikimit, të miratimit dhe të shfrytëzimit të resurseve pyjore si dhe të grumbullohen të dhëna për sasi të disponibël në total, ato që do të përdoren nga banorët/kërkuesit pas miratimit dhe çdo e dhënë shifrore të shoqërohet me gjendjen aktuale, kadastrale, juridike dhe hartografike, topografike.

Menjëherë

14. Nga Policia Pyjore u konstatuan 6 raste prerje drush për të cilat nuk është mbajtur procesverbal pasi kjo gjë i është lënë detyrë komunave përkatëse, por DSHP nuk është interesuar më tej për vijimin e procedurave.

Për këtë rekomandojmë:

DSHP të ndjekë vijimin e procedurave si dhe të marrë informacion nga komunat përkatëse në rastet kur Policia Pyjore konstaton prerje drurësh për të cilat nuk mban procesverbal duke ia lënë detyrë komunave.

Në vazhdimësi

15. Përsa i përket bashkëpunimeve të DSHP Gjirokastrë me institucione të tjera theksojmë se nuk mund të bëhet një vlerësim i saktë në lidhje me efikasitetin real të këtyre bashkëpunimeve, të cilat nuk janë të shoqëruara me plane të përbashkëta pune dhe më tej me arritje të përbashkëta nga procesi i bashkëpunimit, gjë që vë në dyshim zbatimin e tyre në realitet.

Për këtë rekomandojmë:

Bashkëpunimet e DSHP Gjirokastrës me institucione e tjera, të shoqërohen me plane të përbashkëta veprimi dhe më tej me arritje të përbashkëta nga procesi i bashkëpunimit, në mënyrë që të mos mbeten vetëm në letër por të jenë reale dhe rezultative.

Deri më 31.12.204

16. Policia Pyjore e Gjirokastrës nuk ka mbajtur nën kontroll zonat më të prekura nga dëmtimet abuzive dhe nuk ka ngritur postblloqe provizore për mbajtjen nën kontroll të zonave të prekura, siç është përcaktuar në programin e punës së vitit 2012 dhe 2013. Efektiviteti i inspektorëve të zonave dhe në veçanti i personelit të zonave të mbrojtura, ka qenë tepër i ulët në drejtim të mbrojtjes së fondit pyjor dhe zonave të mbrojtura nga dëmet dhe dëmtimet që i shkaktohen kësaj pasurie nga faktori njeri por nga ana tjetër edhe Administrata e zonës së mbrojtur nuk e ka përmbushur detyrën e saj, pasi nuk ka zbatuar gërmën b të VKM nr. 266, datë 24.4.2003 “Për Administratat e Zonave të Mbrojtura” sipas së cilës duhet të kryente rolin e policisë pyjore në drejtim të ruajtjes së zonave të mbrojtura.

Për këtë rekomandojmë:

Policia Pyjore e Gjirokastrës, të mbajë nën kontroll zonat më të prekura nga dëmtimet abuzive duke informuar periodikisht e zyrtarisht me procesverbal për gjendjen e pyjeve dhe të ngrejë postblloqe provizore, për mbajtjen nën kontroll të këtyre zonave si dhe të intensifikojë punën që të rritet efektiviteti i inspektorëve të zonave dhe në veçanti i personelit të zonave të mbrojtura në drejtim të mbrojtjes së këtyre zonave nga dëmtimet që i shkaktohen kësaj pasurie nga faktori njeri.

Menjëherë

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mimoza Lloji, Agron Maksutaj, Irma Shkupi, Keida Muça, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT